



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 182/1 prot.

Tiranë, më 21.02.2022

VENDIM

Nr.27, datë 21.02.2022

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 74, DATË 21.07.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr.74, datë 21.07.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë të aktit nr. 30989, datë 17.12.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe mënyrën e zbatimit të tij”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 557 prot., datë 22.6.2020, nëpunësi ***** ka parashtruar pretendimin se, transferimi i tij i përkohshëm në pozicionin “Doganier, Zyra e Operacioneve Doganore”, Dega Doganore Tre-Urat, Përmet, është bërë në shkelje të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil që kanë të bëjnë me transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Ministrisë së Brendshme të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.74, datë 21.07.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë të aktit nr. 30989, datë 17.12.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe mënyrën e zbatimit të tij”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.74, datë 21.07.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës “Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, në DPD, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është tejkaluar afati maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Konstatohet se, në zbatim të vendimit paralajmërues, me urdhrin nr. 23731 prot., datë 23.12.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është vendosur rikthimi në detyrë i ***** në pozicionin Doganier, në Sektorin e Vlerës Qendër, në Drejtorinë e Vlerësimit Qendër, kategoria e pagës IV-a.

Vërejt se, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 74, datë 21.07.2020, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr.74, datë 21.07.20, të Komisionerit “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë të aktit nr. 30989, datë 17.12.2019, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit ***** dhe mënyrën e zbatimit të tij”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke zbatuar rekomandimet e vendimit nr.74, datë 21.07.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Punoi:H.Peti

Pranoi:E.Hebibasi

Miratoi:A.Basha